



BASHKIA E TIRANËS

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KOMUNIKIMIT DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2016

MEMO

Drejtuar: Z. Erion VELIAJ
Kryetar

Nëpërmjet: Znj. Erka Mato
Drejtoreshë e Përgjithshme
Drejtoreshë e Përgjithshme e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun

Nga: Znj. Manjola SOPOTI
Drejtoreshë e Komunikimit me Qytetarët

Objekti: Mbi raportin e sondazhit rreth projektit të Planit të Përgjithshëm Vendor

Data: 17. 11. 2016

I nderuar Z. Kryetar,

Drejtoreshia e Komunikimit me Qytetarët nëpërmjet Sektorit të Opioneve Qytetare, gjatë muajit tetor - nëntor 2016 zhvilloi një sondazh mbi projektin e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) të Bashkisë së Tiranës. Qëllimi i këtij sondazhi ishte evidentimi i mendimit qytetar rreth projektit të PPV, si një nevojë për kryeqytetin që zgjerohet dita-ditës.

- Sondazhi u krye sipas njësisë primare të kampionimit: qytetarët e 24 njësive administrative.
- Në sondazh u përfshinë: 710 qytetarë mbi 18 vjeç.

✓ **Nga totali i të intervistuarve rezultoi se:**

- 43% e të anketuarve kanë informacion lidhur me PPV;
- Kanali i komunikimit më i shfrytëzuar për marrjen e informacionit rezultoi televizioni me 48%, si edhe mediat online si dhe rrjetet sociale (secila me 19%);
- 11% e të anketuarve kanë marrë pjesë në dëgjuesat publike (për shkak të periudhës së verës);
- 41% e të anketuarve konfirmuan pjesëmarrjen në dëgjuesat vijuese, ndërsa rreth 39% e tyre u përgjigjën me "ndoshta" (në varësi të disponibilitetit të tyre personal);
- 78% e të anketuarve pohuan nevojën për një koncept të ri zhvillimi;
- 61% e të anketuarve do të donin më shumë gjelbërim, lulishte, apo hapësira çlodhëse;
- 45% do të donin më shumë kënde sportive;
- 40-44% vlerësojnë si të rëndësishëm elementët e infrastrukturës, si kanalizimet dhe ujësjellësi;
- 34% e të anketuarve kanë shprehur interes lidhur me rigjenerimin e objekteve të vjetra.
- 41% e qytetarëve kanë vlerësuar si shumë të rëndësishëm riorganizimin e Tiranës në 7 zona policentrike.

✓ **Nga sondimi i fushave kryesore të investimeve rezultoi se:**

- *Rigjenerimi urban* është vlerësuar si shumë i rëndësishëm nga 28% e të anketuarve, i rëndësishëm nga 26% e tyre dhe i pothuajse i rëndësishëm nga 19% e tyre.
- *Lëvizshmëria* është vlerësuar nga 30% e të anketuarve si shumë e rëndësishme dhe nga 31% e rëndësishme.
- *Turizmi* është vlerësuar nga qytetarët me rreth 26% si pothuajse i rëndësishëm, 23% i rëndësishëm, 20% shumë i rëndësishëm.
- *Mjedisi* është vlerësuar nga 44% e të anketuarve si shumë i rëndësishëm dhe elementi kryesor i tij, gjelbërimi zë rreth 61% të nevojave të qytetarëve në çdo zonë banimi.
- *Infrastruktura* është vlerësuar shumë e rëndësishme nga 51% e qytetarëve. Banorët konsiderojnë si përparësi ridimensionimin e kapaciteteve rrugore, trotuareve, korsive të dedikuara etj.
- *Ekonomia* është vlerësuar nga 42% e të anketuarve si shumë e rëndësishme, me element kryesor përthithjen e investimeve dhe zhvillimin e biznesit vendas.
- *Kultura* është vlerësuar nga 32% e qytetarëve si pothuajse e rëndësishme.
- *Agrikultura* është vlerësuar si pothuajse e rëndësishme nga rreth 25% dhe shumë e rëndësishme nga 21%, e vlerësuar kryesisht në njësitë administrative në zonat rurale.
- *Komunikimi* është vlerësuar si shumë i rëndësishëm nga 27% e qytetarëve të intervistuar, vlen të përmendet nisma "One Stop Service".

✓ **Risite e prezantuara në këtë PPV janë vlerësuar si më poshtë:**

- *Transporti publik "car pooling"*, u vlerësua si pothuajse efiçent nga 21% e qytetarëve, ndërsa 25% kanë shfaqur një qëndrim neutral, për shkak të mungesës së informacionit të mëparshëm mbi këtë alternativë transporti.
- *Termoizolimi i ndërtesave* është vlerësuar shumë efiçent nga 42% e qytetarëve.
- *Shtimi i hapësirave të gjelbra* nga 38% e opinionit publik vlerësohet si shumë efiçent dhe 36% si efiçent.
- *Krijimi i një brezi të pyllëzuar përreth territorit urban* nga 36% e qytetarëve vlerësohet si shumë efiçent dhe nga 35% e tyre si efiçent.
- *Shtimi i hapësirave pedonale* përcaktohet si shumë efiçente në një masë prej 32% të mendimit qytetar dhe 33% si efiçente.
- *Përdorimi i TIK në menaxhimin e fluksit të automjeteve*, 29% e opinionit publik vlerësohet si pothuajse efiçent dhe 28% si efiçent.
- *Rivënie në funksion të hekurudhës Tiranë - Durrës* 31% e opinionit publik e vlerësoi si shumë efiçente, po aq 31% si efiçente.

✓ **Sygjerime të të anketuarve:**

- Përmirësimi i infrastrukturë rrugore apo elementëve plotësues të saj;
- Zhvillimi i politikave për eliminimin e ndotjes së mjedisit;
- Përmirësimi i transportit publik.

Për të marrë një informacion më të plotë, bashkëlidhur lutemi gjeni raportin përmbledhës "Mbi projektin e Planit të Përgjithshëm Vendor".

Ju falënderojmë paraprakisht për vëmendjen dhe mbështetjen Tuaj.